

STATUTI

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR G&M KONSTRUKSION Sh.p.k

Sot me dt/22/10 /2020 Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar
G&M KONSTRUKSION Sh.p.k

Themeluar nga ortaket ERMIR NDRECA nr karte identiteti 130305095K lindur ne SHULLAZ dhe banues ne LAC, Rruga nr-5 SHtepi private ne zonen kadastrale nr-3441 me pasurie 6/51

Ortake MHILL NDRECA me numer idi G00929125N lindur me date 29/09/1960 banues ne Lac shtepi private rruga Dod Lleshi nr NR 5

Për te bere te mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj shoqërie e për vijimin e funksionimit e aktivitetit te shoqerise ne baze te ligjit nr. **9901 date 14/04/2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare"**, është përpiluar ky statut si me poshtë.

Neni 1

KREU I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Sot, më 22/10/2020 (data e nënshkrimit të këtij Statuti), Ortaket pjesëmarrës ne kete statut , kemi krijuar një shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, SH.P.K. Shoqëria e fiton te drejtën e personit juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

Neni 2

Shoqëria tregtare emërtohet **G&M KONSTRUKSION Sh.p.k**

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare "**G&M KONSTRUKSION Sh.p.k**
do te je;

INVESTIM,FINANCIM DHE KONSULTIM SI ME POSHTE:

- Hapje gurorje , prodhim guri gelqeror, prodhim inertesh te dimensioneve te ndrusheme dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice.
- Prodhim pllaka guri, granile , fino, gure per ndertim tregtimi dhe importimi i tyre.
Punime ne pastrimin e kanaleve kulluese, kanalizime te ujrave te ndotura dhe ne hidrovore e diga. Punime ne ujsjellsa te ndryshem
- Zhvillim agroturizmi ne zonat rurale , ndertimi i komplekseve te ndryshem turistik dhe menagjimi i tyre. Ndertim stallash bujqesore dhe blegtorale per aktivitet.

- Importimi i matrialeve ndertimore si pllaka, kolle, tjegulla, lende drusore, tulla, hekur dhe cdo lloj materiali tjetër që ka të bëjë me ndertimin e objekteve të ndryshme, si dhe tregtimi i tyre.
- Importimi i paneleve diellor sebashku me aksesoret e tyre, si dhe montimi i tyre për prodhim dhe shitje energjike.
- Ndertim pikash turistike në zona të ndryshme të vendit.
- Importimi i makinerive industriale dhe tregtimi i tyre.
- Importimi i mjeteve të renda si eskavatore, komjon e të tjera dhe tregtimi i tyre
- Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit dhe për të tretë.
- Hapje lokalesh, resorantesh, hotelesh dhe menagjimi i tyre.
- Hapje terrenesh sportive për trajnime sportistash e tjetër. Ndertime objektesh të ndryshme social kulturore, industriale, rrugore, impiante teknologjike termike dhe kondicionimi, elektrike dhe elektronike.
- Mirmbajtje rrugësh të ndryshme, mirmbajtje kanalesh vaditëse.
- Ndertim minierash, nxjerrje minerali dhe import-eksport i tyre.
- Ndertim hidrocentralesh, prodhim dhe shpërndarje të energjisë elektrike nga 20 deri 50 megavat.
- Përdorimi i lendeve plasese.
- Projektim, drejtim, zbatim, supervizion e kolaudim të punimeve në fusha të ndryshme.
- Tregtim karburante dhe vajrave lubrifikante
- Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.
- Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridike ose fizike ose me cilëndo tjetër shoqëri me të njëjtin objekt veprimtarie brenda ose jashtë vendit.
- Import-eksport shitje me shumice dhe pakice i mallrave industriale si elketroshtepiake, produkte të ndryshme, elektrike dhe elektronike, aksesore të ndryshme etj.
- Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.
- Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridike ose fizike ose me cilëndo shoqëri tjetër me të njëjtin objekt veprimtarie brenda ose jashtë vendit.

Neni 4

Shoqëria në baze të legjislacionit Shqiptar, ka të drejtë të hapë filiale, dege, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

Neni 5

Shoqëria e ka selinë në , MILOT, PROZHME, Rruga Dod Lleshi nr-5 "zyre" në zonën kadastrale nr-3441 nr- i pasurisë 6/51.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Ortakeve. Shoqëria në baze të legjislacionit ka të drejtë të hapë filiale, dege, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

Neni 6

Kohëzgjatja e veprimtarisë të Shoqërisë Tregtare është për një afat të pa caktuar.

Neni 7

KREU II

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare është 100 000 (njëqindmijë) leke.

Kapitali themeltar është i ndare në 2 Kuota, ku çdo kuote ka vlerë 50000 leke.

ERMIR NDRECA nje kuote = 50000 lek

MHILL NDRECA nje kuote = 50000 lek

Neni 8

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

ERMIR NDRECA zotëron 50%

MHILL NDRECA zotëron 50%

Kontributet në para do të paguhen plotësisht menjëherë me neneshkrimin e statutit. Kontributet në natyrë do të kalojnë Shoqërisë menjëherë pas regjistrimit në QKB.

Pjesët e kapitalit themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakëve të vetëm.

Neni 9

Pjesët e kapitalit themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakut të vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyrë, por asnjëherë në kontribute në shërbime.

Kur pjesët e kapitalit themeltar përfaqësojnë kontribute në natyrë, vlerësimi i tyre bëhet nga një ekspert për kontributet nëpërmjet një raporti që i bashkëngjitet statutit. Eksperti caktohet nga Ortaket e shoqërisë.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.

Neni 10

ZMADHIMI I KAPITALIT

Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

Zmadhimi i kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribute në para, bëhet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Zmadhimi i kapitalit pjesërisht ose plotësisht me anë të kontributeve në natyrë, bëhet sipas kërkesave të nenit të Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008.

Eksperti i autorizuar për kontributet emërohet me vendim të gjykatës ose sipas kërkesës së presidentit të shoqërisë.

Neni 11

ZVOGELIMI I KAPITALIT

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga asambleja e ortakut të vetëm, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 12

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Pjesët e kapitalit janë lehtësisht te transferueshme me rruge trashëgimie. Gjithashtu janë lirisht te transferushme ndërmjet bashkëshorteve, si edhe ndërmjet paraardhësve e pasardhësve .

Pjesët e kapitalit janë lehtësisht te transferueshme dhe vendosen me vendim nga Ortaku i vetem i shoqerise, ne perputhje me nenin 87 te ligjit te shoqerive tregtare . Ne rast konflikti , kompetente për zgjidhjen e tij është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Neni 13

KREU III

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Organet drejtuese te shoqërisë janë

-Ortaket e shoqerise

Administratori Ligjor i shoqerise eshte **Z. ERMIR NDRECA**

Administratori i shoqerise do te pergjigjet per te gjithë aktivitetin qe do te zhvilloje shoqeria .

Administrator i shoqërisë eshte **Z. ERMIR NDRECA**, me afat Pese vjecar. Pervec kesaj administratori shkarkohet nga Gjykata per shkelje te ligjit.

Neni 14

Organi me i larte i vendim marrjes te shoqërisë jane ortaket .

Ortaket e shoqerise munde ti delegojnë kompetencat e tij personave te zgjedhur Vendimet e tije evidentohen ne një regjistër.

Neni 15

Ortaket e shoqerise vendosin për çështjet e mëposhtme dhe duke mos u kufizuar vetëm ne to:

1. Emërimi ose shkarkimi i administratorit , eksperteve kontabël te autorizuar dhe likuiduesve.
2. Miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit .
3. Miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes te fitimit vjetor.
4. Ndryshimi i statutit
5. Ndryshimin e selisë, emërtimin.
6. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar.
7. Transferimi i pjesëve te kapitalit themeltar tek te tretet.
8. Mbarimi i veprimtarisë te shoqërisë apo likuidimi i saj.
9. Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar ne një forme tjetër shoqërie tregtare.

Neni 16

Raporti i administrimit inventari dhe llogarite vjetore redaktohen nga administratori.

Ortaku i vetem i shoqerise miraton llogarite nëse është e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabël te autorizuar , brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortaku i vetëm i shoqërisë, ka te drejte te marre ne çdo moment dokumentet e sipërpërmendura për 3 vitet e fundit financiare. Ai mund te ndihmohet nga eksperti i zgjedhur prej tij ,i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

Neni 17

Ortaket shoqerise merrin vendime siç përcaktohet në kete statut per:

- a) për ndryshimin e statutit,
- b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
- c) shpërndarjen e fitimeve,

d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 18

Ndryshimet ne statutin e shoqërisë vendosen nga e ortaket e shoqërisë. Në kushtet e mësipërme Ortaket e vendosin edhe për çështje te tjera qe ligji "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" u referohet shprehimisht. Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak për te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

Neni 19

Administrator i shoqërisë është **ERMIR NDRECA** per nje afat Pese vjecar.

Neni 20

Administratori i shoqerise ka te gjitha te kompetencat për te vepruar në marrëdhënie me te tretet ne emër dhe për llogari te shoqërisë.

Administratori ka te drejte te kryej te gjitha veprimet lidhur me administrimin e shoqërisë.

Administratori ka te drejte te hyje ne marrëdhënie kontraktore ne emër dhe për llogari te shoqërisë duke mos u kufizuar vetëm ne :

- a) Ndjekja e te gjithë procedurave administrative lidhur me marrjen e licencave për ushtrimin e aktivitetit, marrjen e lejeve nga organet kompetente ne rast nevojës për realizimin e interesave te shoqërisë, ne kuadër te marrëdhënieve me organet e pushtetit vendor dhe qendror.
- q) Nënshkrimi i kontratave individuale te punës si dhe zgjidhjen e tyre. Nënshkrimin e kontratave te Furnizimit, agjencisë ,pronësisë ,shkëmbimit etj,ne kuadër te përmbushjes te objektit te veprimtarisë te shoqërisë .
1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - a) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - b) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - c) përgatise dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - e) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - f) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - g) Te perfaqesoje shoqerine ne kryerjen e veprimeve bankare me llogarite bankare ,qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte ,duke pasur te drejte te kryeje cdo veprim me to si terheqje ,depozitime ,transferta etj.
 - h) Neneshkrimi i kontratave individuale te punes si dhe zgjidhjen e tyre.
 - i) Neneshkrimin e kontratave ne kuader te permbushjes te objektit te veprimtarise te shoqerise .
 - j) Administratori gezon te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne maredhenje me te tretet gjithashtu edhe perpara te gjitha organeve shteterore ,administrative dhe

gjyqesore ,te te gjitha instancave. Personat e trete qe do te caktohen si perfaqesues te shoqerise nepermjet prokures se posaceme te leshuara nga administratori do te kene te drejte te veprojne per emer dhe llogari te shoqerise ,brenda tagrave qe vete administratori gezon sipas ketij statuti . Ne te gjitha rastet per cdo tejkallim te kompetencave nga personi i trete ,administratori do te pergjigjet solidarisht me te kundrejt shoqerise.

2. Administratori eshte i detyruar te therase Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

4. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

5. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

6. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

VOTIMI ME PROKURË

a) Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga Administratorët):

b) Unë/ i/të nënshkruari/t, _____, ne cilësinë e ortakut të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më *data/muaji/ viti* dhe në çdo mbledhje të shtyrë. Nënshkruar më *data/muaji/ viti* .

c) Në rastet kur dëshirohet tu jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga Administratorët:

d) Unë/Ne i/të nënshkruari/, ne cilësinë e ortakut te shoqerise/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më data /muaji/ viti dhe në çdo mbledhje të shtyrë. Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më *data/muaji/ viti*

e) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e

Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

f) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 21

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar ,i emëruar për çdo vit financiar me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga Asambleja e Shoqërisë.

Neni 22

Për punonjësit që do të punësohen në shoqërinë Tregtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin. Paga e punës nuk është e kufizuar por ajo nuk mund të jete me e ulet se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të qeverisë.

Neni 23

KREU IV

MARRËDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

Viti financiar fillon me datën 1 Janar dhe mbaron me datën 31 Dhjetor të çdo viti . Llogarite vjetore ,inventari,raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël ,miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 24

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës të fitimit ,ortaket përcakton pjesën që i takon mbi fitimin ,te cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezerve të domosdoshëm (jo me pake se 1/20 e fitimit të çdo viti ,deri sa ky fond të arrij vlerën e 1/10 të kapitalit themeltar) si dhe të jene zbritur ose shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 25

Llogarite ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe ,në leke ose në valute të huaja. Veprimtaria ekonomike mbahet në baze të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin që detyrimisht do të pasqyrohen në bilanci të përpiluar nga ekspertet kontabël të autorizuar të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore për punën e tyre.

Neni 26

Shoqëria tregtare ,me qëllim që të bëjë sa më të lehta dhe më të shpejta pagesat me të tretet ,do të hapë llogari bankare në një nga bankat që janë të njohura nga shteti Shqiptar ,vendos ose të huaja ,te cilat do të administrohet nga administratori.

Neni 27

KREU V

PRISHJA, LIKUJDIMI

Shoqëria prishet me vendim të ortakeve.

Shoqëria mund të shndërrohet në një nga format e përcaktuara nga ligji sipas shumicës të kërkuar nga ligji për çdo rast konkret .

Neni 28

Shoqëria tregtare hyn në procesin e likuidimit që në momentin e vendosjes për prishjen e saj . Për fillimin e këtij procesi Ortaket emërojnë një likuidues i cili

paraqet raportin e likuidimit ,gjendjen e aktivitetit te pasivitetit te shoqërisë ,mbi mënyrën e ndjekjes te operacionit te likuidimit dhe afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre. Ne fund te procesit te likuidimit , Ortaket vendosin mbi bilancin përfundimtar ,mbi aktin dhe rregullsinë e likuidimit ,mbi mbylljen e procesit te likuidimit te shoqërisë .

Neni 29Te gjitha mosmarrëveshjet qe do te lindin gjate ekzekutimit te këtij statuti dhe kontratës se themelimit gjate ekzistencës te shoqërisë ,si gjate kryerjes te veprimtarisë ashtu edhe ne procesin e likuidimit, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësore Tirane.

Neni 30

Te gjitha ndryshimet dhe plotësimet e statutit duhet te kryhen ne te njëjtën forme dhe sipas procedurës se njëjte te nevojshme për miratimin e statutit .

Neni 31

Ky statut është hartuar ne 4 kopje nga te cilat njëra depozitohet ne zyrën e noterisë Tirane ,njëra depozitohet ne QKB- , njëra ne Zyrën e Tatimeve Tirane dhe kopja e katërt mbahet ne dokumentet e shoqërisë .

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve Themelus

- ERMIR NDRECA MHILL NDRECA

Ermir Ndreca Mhill Ndreca

